

NJOFTIM

Në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM-së nr. 531 datë 7.9.2023 “Per krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, bëjmë me dije se Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në cilësinë e pronarit me 100% të aksioneve, ka regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit shoqërinë aksionare “Operatori i Blerjeve të Përqendruara”, me NIPT M41501042N, me objekt kryerjen e veprimtarive ndihmëse për prokurimin publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësise.

Gjithashtu, bëjmë me dije se tarifat për shërbimet e OBP sh.a janë përcaktuar në VKM-në nr. 245, datë 17.4.2024 “Për përcaktimin dhe përlllogaritjen e tarifës, për kryerjen e veprimtarive ndihmëse, për prokurimin publik nga shoqëria aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a”.

Njoftojmë institucionet se kërkesat e tyre që kanë për prokurim objekt i VKM-së nr. 531 datë 7.9.2023 “Per krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise” tashmë do duhet t’i drejtohen Operatorit të Blerjeve të Përqendruara me adresë Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Bulevardi Dëshmoret e Kombit, nr. 3, Tiranë.

Duke ju falenderuar,

ADMINISTRATORI

ARLINDA POGAJ

